



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.
2019

Ballsh, më ____ . ____ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën www.app.gov.al

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

BASHKIA MALLAKASTËR

Data 03.01.2019

Për: **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, me NIPT L38109801T, me adresë Lgj."5 Shkurti" Ballsh & “FLED” shpk, me NIPT K17621104C, me adresë Lgj."Havaleas", Rruga Ura e Kozares, Kuçovë.**

* * *

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-94531-11-16-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrugëve në fshatra”**, me fond limit **52.985.965** (pesëdhjetë e dymilion e nëntëqind e tetëdhjetë e pseëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**, me afat 6 muaj nga lidhja e kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.47, datë 26 nëntor 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, me NIPT L38109801T & “FLED” shpk, me NIPT K17621104C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 47.457.410 (dyzetë e shtatëmilion e katërqind e pesëdhjetë e shtatëmijë e katërqind e dhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 50.900.272 (pesëdhjetëmilion e nëntëqindmijë e dyqind e shtatëdhjetë

e dy) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018 – Tetor 2018.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “i”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se ka minimalisht tre manovratorë, të pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë dhe të figurojnë në listëpagesa.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “j”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion shoqërues që vërteton se disponon mjetet e makinerië sipas shtojcës 10.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “m”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur grafikon e punimeve në përputhje afatin kohor të kërkuar për realizimin e punimeve.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, me NIPT L38109801T, me adresë Lgj."5 Shkurti" Ballsh & “FLED” shpk, me NIPT K17621104C, me adresë Lgj."Havaleas", Rruga Ura e Kozares, Kuçovë,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **47.457.410** (dyzetë e shtatëmilion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.12.2018

Ankesa: Për këtë procedurë prokurimi nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Agron Kapllanaj